

STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE
me përgjegjësi të kufizuar

B B W CONSULTING ShpK

Në Tiranë, sot më datën 15.01.2018, Ortakët

1. **Stephan WINGS**, dt. 22.07.1963 dhe banues në Lahnstein, Schwarzer Weg 1 RFGjermane
2. **Agron Asllan LAMAJ**, dt. 11.03.1954 dhe banues në Tiranë Rr. R. Çollaku, P. Aurora, Ap. Nr. 22 Tiranë.

Mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar

B B W CONSULTING ShpK

duke paraqitur edhe statutin e hartuar si më poshtë.

NENI 1

Emërtimi i shoqërisë

- 1.1. Emërtimi i shoqërisë është **B B W CONSULTING** shpk, e cila do të ketë vulën dhe logon e saj. Në çdo rast, emërtimi i saj do të paraprihet ose pasohet nga:
 - a) fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet sh.p.k.
 - b) numëri i regjistrimit;
 - c) selia.

NENI 2

Forma ligjore e shoqërisë

- 2.1. Shoqëria tregtare **B B W CONSULTING** shpk, është person juridik shqiptar, e formës së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe që vepron sipas dispozitave të këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit.

NENI 3

Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia Qendrore e shoqërisë **B B W CONSULTING** shpk, është në Tiranë, në adresën: Rr. K. Karafili, nr. 27 Tiranë. Shoqëria rezervon të drejtën e transferimit të selisë së saj në një adresë tjetër.
- 3.2. Shoqëria shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Me vendim të Mbledhjes së Ortakëve, mund të krijohen filiale, agjensi dhe përfaqësi edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

- 4.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare **B B W CONSULTING** shpk është ofrimi i shërbimeve të Konsulencës për individë apo shoqëri, vendase apo të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e shtetit shqiptar.
- 4.2. Me konsulencë kuptohet në veçanti, ndërmjetësimi, nxitja për kryerjen e investimeve të huaja si dhe për lidhjen e kontakteve tregtare ndërmjet tregtarëve dhe investitorëve të dy shteteve: Shqipëri dhe RFGjermane në territoret përkatëse të tyre; për krijimin e ndërmarrjeve tregtare ose çdo forme tjetër të bashkëpunimit tregtar ose ekonomik në Shqipëri; mbulimi, përkujdesja dhe trajtimi i problemeve organizative, juridike, organizimit dhe mbrojtjes së interesave juridike dhe ekonomike të ndërmarrjes si dhe kujdesi në fushën e taksave; mbrojtja e investimeve të huaja në Shqipëri; gjetja e mundësive për sigurimin e ndihmës dhe mbështetjes financiare, digitalizimi i ndërmarrjes dhe përgatitja e tyre për pjesëmarrje në tregtinë ndërkombëtare, si dhe ndërtimi i platformave të sukseshme të ndërmarrjeve.
- 4.3. Konsulenca mund tu ofrohet edhe organeve të pushtetit vendor ose institucioneve publike në drejtim të gjetjes së mundësive për të përfituar fonde dhe ndihma financiare të EU; në marrjen e masave për përmirësimin e infrastrukturës (rrugë dhe kanalizime ose furnizimi me ujë); lidhja e kontakteve ndërmjet atyre dhe organeve analoge në shtetin gjerman; krijimi i lidhjeve me dhomat e tregtisë dhe industrisë gjermane për realizimin e projekteve të përbashkëta; hapja e tregjeve në vende europiane si dhe ndihma për digitalizimin dhe organizimin e këtyre organeve.
- 4.4. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, që do të konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

- 5.1. Ushtrimi aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë, Ortakët

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë **B B W CONSULTING** shpk është 20 000 lekë (njëzetëmijë), që përfaqëson kontributet në para të ortakëve.
- 6.2. Ky kapital themeltar ndahet në dy kuota.
- 6.3. Ortakët e shoqërisë janë:
- Agron LAMAJ 1 kuotë 50% 10 000 Lekë
 - Stephan WINGS 1 kuotë 50% 10 000 Lekë.
- 6.4. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 7

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar

- 7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.
- 7.2. Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me vendim të Mbledhjes së ortakëve.

NENI 8

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 8.1. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet simbas normave ligjore tregtare, duke bërë dhe ndryshimin në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 9

Veprimet financiare

- 9.1. Shoqëria hap llogari bankare në lekë dhe në cdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj. Administratori i emëruar nga Mbledhja e ortakëve depoziton firmën e tij origjinale në Bankat ku janë celur llogaritë.

Neni 10

Organet drejtuese të shoqërisë

10.1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:

Mbledhja e ortakëve;

Administratori.

NENI 11

Mbledhja e Ortakëve

11.1. Mbledhja e ortakëve ka kompetencat e përcaktuara në këtë statut të shoqërisë **B B W CONSULTING shpk** si dhe ato të përcaktuara në ligjin tregtar.

NENI 12

Administratori

- 12.1. Administratori kryen veprimet e administrimit dhe ushtron të gjitha kompetencat në interes dhe në emër të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të atyre që ligji dhe ky Statut ia jep shprehimisht Mbledhjes së ortakëve.
- 12.2. Administratorit nuk i lejohet të marrë hua nga shoqëria, të japë pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhet dorëzanës apo garantues në emër të saj në angazhimet ndaj të tretëve.
- 12.3. Administratori është individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve ose që bien në kundërshtim me këtë Statut dhe përgjigjet për dëmin e shkaktuar me faj.
- 12.4. Administrator i shoqërisë caktohet

Z. Agron A. LAMAJ.

Me një afat prej 5 vjetësh.

NENI 13

Llogarite vjetore

- 13.1. Veprimet ekonomiko financiare të shoqërisë mbyllen më datën 31 Dhjetor të cdo viti.
- 13.2. Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortakët, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të

mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.

- 13.3. Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë.

NENI 14

Prishja e shoqërisë

- 14.1. Prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak që parashikohet në ligj ose me vendim të Mbledhjes së ortakëve. Procedura e mëtejshme i referohet normave tregtare.

Bërë dhe nënshkruar në Tiranë më 15.01.2018

Ortakët

e shoqërisë **B B W CONSULTING ShpK**

Stephan WINGS

Stephan Wings
Stephan Wings

Agron A. LAMAJ

Agron Lamaj
Agron Lamaj